



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

Anr.165/2025

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtaret: Skënder Çoçaj kryesues, Kymete Kicaj dhe Arsim Hamzaj anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e Subjektit Politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, të paraqitur kundër Subjekti Politik Koalicioni Për Familje, me seli në Prishtinë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjatë fushatës zgjedhore, për Zgjedhjet e Përgjithshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës që do të mbahen më datë;09.02.2025, në seancën e panelit të mbajtur më datë; 26.01.2025, merr këtë,

V E N D I M

- I. Pranohet e bazuar ankesa e Subjektit Politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, Anr.165/2025, e datës;23.01.2025.
- II. Subjektit politik Koalicioni për Familje me seli në Prishtinë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, i shqiptohet dënimi më gjobë në lartësi prej 1.500.00 (njëmijë e pesëqind) euro.
- III. Detyrohet Subjekti Koalicioni për Familje, me seli në Prishtinë, që gjobën e shqiptuar si në pikën -II-, të dispozitivit të këtij vendimi, ta paguaj në afat prej 15 ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij vendimi.

A r s y e t i m

Me datë;23.01.2025, PZAP-i, ka pranuar një ankesë nga Subjektit Politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, me të cilën pretendon se më 22 janar 2025, në qytetin e Suharekës, Subjekti politik Koalicioni për Familjen, ka vendosur posterin në hapësirat/rrugët publike, konkretisht në rrugën “ Xhavit Bajraktari”, të kandidates për deputete Dorontina Kokollari, ky baner/poster është vendosur në shtyllat elektrike dhe ndriçuese të rrugës. Tutje në ankesë theksohet se ky veprim i subjektit politik Koalicioni për Familjen, është në kundërshtim me nenin 34 paragrafi 1, nën paragrafi 1.2, të Ligjit Nr. 08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës -LZP-së. Sipas nenit 34 paragrafi 1 nën

paragrafi 1.2 i LZP-së parashihet se: “1.2. vendosja e njoftimeve, pllakateve dhe posterëve, ose përndryshe vendosja e emrave të tyre ose e sloganeve në lidhje me fushatën zgjedhore brenda ose jashtë ndërtesave publike ose godinave në apo mbi rrugët publike në shenjat publike të trafikut, brenda ose jashtë hapësirave ose ndërtesave të zëna ose ndryshe që shfrytëzohen nga organizatat ndërkombëtare ose brenda ose në hapësirat private pa lejen e pronarëve ose shfrytëzuesve. Përmes këtij veprimi, subjekti përkatës, ka cenuar rëndë dispozitat përkatëse ligjore. Andaj, duke u mbështetur në bazën ligjore dhe argumentet e lartcekura, kërkojnë që masa e sanksionit të vendoset në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Si provë parashtruesi i ankesës ka bashkangjitur fotografi që dëshmojnë vendosjen e banerit/posterit në kundërshtim me LZP-në.

PZAP, me datë 24.01.2025 iu është drejtuar me kërkesë për përgjigje Subjekti Politik Koalicioni për Familje, të parashtruar nga ankuesi Subjekti Politik Lëvizja Vetëvendosje, mirëpo Subjekti Politik Koalicioni për Familje, nuk është përgjigjur as në afatin e paraparë deri më datë;25.01.2025, e as më pas.

Paneli, nga fotografitë e ofruara si provë nga parashtruesi i ankesës, të cilat gjenden në shkresat e lëndës, në mënyrë të padyshimtë ka konstatuar se vendosja e posterit e kandidatës për deputete nga radhët e subjektit politik Koalicioni për Familjen, Dorontina Kokollari, ka shfrytëzuar jashtëligjshëm dhe në kundërshtim me dispozitat ligjore hapësirat publike konkretisht në shtyllën elektrike në rrugën “Xhavit Bajraktari” në komunën e Suharekës, në kundërshtim me nenin 34, paragrafi 1 të Ligjit Nr.08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës LZP, konkretisht neni 34, paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 i LZP-së parashihet: “1. Gjatë periudhës së fushatës, subjekti politik, mbështetësit ose kandidatët e tij, ndalohen nga bërja e ndonjërs si në vijim:1.2 vendosja e njoftimeve, pllakateve dhe posterëve, ose përndryshe, vendosja e emrave të tyre ose e sloganeve në lidhje me fushatën zgjedhore brenda ose jashtë ndërtesave publike ose godinave, në apo mbi rrugët publike, në shenjat publike të trafikut, brenda ose jashtë hapësirave ose ndërtesave të zëna ose, ndryshe, që shfrytëzohen nga organizatat ndërkombëtare, ose brenda ose në hapësirat private pa leje e pronarëve ose shfrytëzuesve.

Andaj duke u mbështetur në nenin 117.3 të LZP-së ku përcaktohet se: “vendosja për ankesat nga PZAP-ja mbështetet në dëshmi të qarta dhe bindëse”, Paneli vlerësoj se pretendimet e tilla janë të qëndrueshme dhe si të tilla i pranoi, sepse kjo shkelje ka të bëjë me faktin se Kodi i Mirësjelljes i detyron të gjitha subjektet politike, kandidatët, anëtarët e subjekteve dhe mbështetësit e tyre që ta respektojnë këtë kod me qëllim të krijimit të kushteve që gjatë periudhës së fushatës, veprimet e subjekteve politik të jenë në një atmosferë të tolerancës demokratike, paqes dhe respektit për sundimin e ligjit se nga veprimet e përshkuara në ankesë nga parashtruesi i ankesës paraqesin shkelje të dispozitave të lartcekura, dhe të njëjtën e pranoi si të bazuar. Paneli ka shqyrtuar pretendimet në përgjigje në ankesë, mirëpo të njëjtat i ka refuzuar si të pabazuara, për arsye se, nga provat, përkatësisht fotografitë e ofruara si provë nga parashtruesi i ankesës, të cilat gjenden në shkresat e lëndës, në mënyrë të padyshimtë ka konstatuar se posterit i kandidatës për subjektin politik, Koalicioni Familja është e vendosur në rrugën “Xhavit Bajraktari”, përkatësisht në shtylla elektrike.

Paneli, me rastin e vendosjes se gjobës si në dispozitiv të këtij vendimi, ka marrë parasysh të gjitha rrethanat si në vijim: natyrën e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor në fjalë, shkallën dhe peshën e shkeljes, shkeljet e Ligjeve zgjedhore në fuqi që ka bërë subjekti në fjalë në këto zgjedhje si dhe faktin që shkelja nga ky subjekt është bërë për herë të parë, njëherit subjekti politikë në fjalë nuk është përfitues i fondit për financimin e subjekteve politike përmes buxhetit të Republikës së Kosovës.

Nga arsyet e theksuar më lartë duke bazuar nenin 117 paragrafi 3, neni 118 paragrafi 1 dhe neni 120 paragrafi 1 nen parafi 1.3 të LZP-së, të LZP-së, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës
A.nr.165/2025, datë;26.01.2025



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 118 par. 4 të LZP-së.